



AIPS mundëson
kryerjen e pagesave të
mëdha

- Sistemi AIPS kryen shlyerjen në kohë reale të pagesave me vlerë të madhe midis bankave.
- Sistemi është pronë e Bankës së Shqipërisë dhe operohet prej saj.
- Në këtë sistem marrin pjesë 16 banka të nivelit të dytë dhe Qeveria Shqiptare.
- Edhe individët të cilët janë klientë të bankave të nivelit të dytë mund të kryejnë pagesa ekspres nëpërmjet këtij sistemi.
- Për çdo pagesë bankat i paguajnë Bankës së Shqipërisë 250 lekë dhe tarifa vjetore për pjesëmarrje në sistem është 350 000 lekë.
- Pagesa kryhet në moment.
- Pagesa nuk mund të kryhet në rast se në llogari nuk ka fonde të mjaftueshme.
- Sistemi u mundëson bankave marrjen e kredisë brenda ditës me kolateral.
- Sistemi mundëson administrimin e menjëhershëm të likuiditetit për Bankën e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë pjesëmarrëse në sistem.
- Sistemi mundëson shkëmbimin e informacionit me sisteme të tjera në Bankën e Shqipërisë.
- Për funksionimin e një sistemi të tillë punojnë një grup specialistësh të pagesave dhe të informatikës.
- Funkcionet që tani kryhen nga ky sistem më parë kryheshin në mënyrë të paautomatizuar dhe bankat njoftoheshin për pagesat vetëm një ditë më vonë.
- Me vënien në funksionim të sistemit AIPS pagesa kryhet menjëherë dhe njoftimi gjithashtu, merret menjëherë, duke shkurtuar kështu në maksimum kohën e kryerjes së pagesave nga bankat e nivelit të dytë.
- Orari i punës së sistemit për të tretët është 09:00-14:30 kurse për pagesat ndërmjet bankave 09:00-15:30.
- Përdorimi i këtij sistemi ul përdorimin e parave në dorë.
- Data e fillimit të punës së sistemit është 31 janar 2004.

AECH mundëson
kryerjen e pagesave të
vogla



- Sistemi AECH kryen kryqëzimin e pagesave në vlerë të vogël.
- Sistemi është pronë e Bankës së Shqipërisë dhe operohet prej saj.
- Orari i punës i këtij sistemi është 09:00-15:30.
- Në këtë sistem marrin pjesë 14 banka të nivelit të dytë.
- Kosto për urdhërpagesa në vlerë të vogël është 4 lekë. Për instruksione debitimi direkte kosto është 5 lekë. Tarifa mujore e pjesëmarrjes në sistem është 7500 lekë.
- Instruksionet e debitimit direkt mundësojnë midis të tjerash dhe kryerjen e pagesave për ujin, dritat e telefonin nga individët dhe bizneset.
- Ky sistem kursen kohë dhe para për kompanitë dhe individët.
- Përdorimi i këtij sistemi ul përdorimin e parave në dorë.
- Data e fillimit të punës së sistemit është 8 korrik 2005.
- Funkcionet që tani kryhen nga sistemi AECH më parë kryheshin në mënyrë të paautomatizuar.
- Me vënien në funksionim të sistemit AECH, informacioni për pagesat merret menjëherë duke shkurtuar kështu kohën e kryerjes së pagesave nga bankat e nivelit të dytë.
- Sistemi AECH ka ndërfaqe automatike me sistemin AIPS, e cila realizon shlyerjen e pagesave të kryqëzuara në AECH dhe shkëmbimin e informacionit midis sistemeve.

Departamenti i Kontabilitetit dhe
Pagesave
Tel: 222 152; 222 153
ext. 194

Departamenti i Teknologjisë së
Informacionit dhe Statistikës
Tel: 222 152; 222 153
ext. 162